



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit

Programi: Master i udhëheqjes arsimore

Kursi: Ndryshimet në arsim

Statusi i kursit: Obliguar

ECTS: 6

Ligjëruesi/t: Blerim Saqipi, PhD

Kontaktet:

e-mail: blerim.saqipi@uni-pr.edu

I. Përshkrimi

Ky kurs ka për synim që studentët të njihen me konceptet dhe proceset e ndryshimeve në arsim. Secili sistem i arsimit është në baza të rregullta i përfshirë në procesin e ndryshimeve dhe në këtë kontekst ndryshimet në arsim shihen si proces dhe jo një pikë e caktuar e synuar. Në anën tjetër secili punonjës i arsimit ndërlidhet me ndryshimet në arsim dhe ka një rol dhe përgjegjësi në zhvillimin e cilësisë së arsimit varësisht nga konteksti dhe rrethanat në të cilat funksionon ai/ajo. Të kuptuarit e ndryshimit në arsim është një proces mjaft kompleks dhe mënyra si ne si individë sillemi, mënyra si menaxhohet institucioni shkollor dhe mënyra si planifikohet dhe menaxhohet sistemi i arsimit janë esenciale por edhe koherenca midis këtyre niveleve është thelbësore për menaxhimin e ndryshimeve drejt gjendjes së dëshiruar.

II. Rezultatet e pritura

Me përfundimin e kursit, studentët do të jenë në gjendje:

- të demonstrojnë të kuptuar të thellë të koncepteve kryesore në fushën e ndryshimeve në arsim;
- të analizojnë kompleksitetin, rolin e palëve të ndryshme dhe procesin e ndryshimeve në arsim;
- reflektojnë për faktorët që ndikojnë në realizimin e ndryshimeve dhe sfidave që dalin si pengesa kryesore në menaxhimin e suksesshëm të ndryshimeve;
- analizojnë faktorët kryesor në qëndrueshmërinë e ndryshimeve të nisura në një sistem të

- arsimit;
- analizojnë sistemin e arsimit në Kosovë dhe ndryshimet e bëra krahas koncepteve teorike në literaturë.

III. Metodologjia e mësimdhënies

Metodologjia e mësimdhënies që do të zbatohet në këtë kurs do të jetë kryesisht interaktive dhe e orientuar drejt involvimit të studentëve në diskutime. Rëndësi e veçantë i kushtohet aspekteve praktike të shtjellimit të temave konkrete ku studentët do të angazhohen në detyra praktike në lidhje me temat përkatëse. Prezantimet e mësimdhënësit do të shërbejnë si pikënisje dhe formulim i kornizës brenda së cilës do të orientohet puna e studentëve.

IV. Plani i detajuar i kursit

Java	Tema	Literatura	Aktiviteti/Komenti
1	Prezantimi i kursit Paraqitja e sillabusit dhe detyrave	Sillabusi	Diskutim i hapur me studentë për përvojën dhe pritjet e tyre dhe të kursit
2	Të kuptuarit e ndryshimit në arsim: konceptet kyçe	[2] fq. 13-76 [1] fq. 1-21	Reflektim i studentëve: filozofia ime e ndryshimeve në arsim
3&4	Ndërlikueshmëria e procesit të ndryshimit	[1] fq. 22-48	Reflektim mbi 8 mësimet e ndryshimit
5&6	Ndryshimi i individëve (mësimdhënësit dhe drejtorët)	[1] fq. 119-167 [2] fq. 177-223 Artikulli 1 & 2	
7	Testi 1		
8&9	Ndryshimi i shkollës - klima dhe sjellja	[1] fq. 49-118	

	organizative	[3] [4] 175-213 Artikulli 3	
10 & 11	Ndryshimet sistematike: - Teoria e sistemeve; të mësuarit trelakor; mënyra e katërt e ndryshimeve	[1] fq. 1-8; 155-167 [2] fq. 321-342 [5] Tërë libri ofrohet në ligjëratë të përmbledhur Artikulli 4 & 5	Studentët në grupe identifikojnë një rast të ndryshimit në arsim dhe analizojnë sipas 'mësimit trelakor'
12	Procesi i ndryshimit: Fillimi - implementimi – qendrueshmëria	[2] fq. 81-170	
13&14	Sistemi i arsimit në Kosovë nga perspektiva historike dhe aktuale e ndryshimeve		
15	Përmbyllje dhe reflektim		

Vlerësimi

Vlerësimi në këtë kurs zbaton qasjen e vlerësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi në këtë kurs synon jo vetëm të verifikojë aftësitë dhe arritjet e studentit të caktuar në zotërimin e përmbajtjeve mësimore por edhe zhvillimin e të kuptuarit të tyre të sistemit të arsimit në Kosovë dhe procesit të ndryshimit në arsim.

Forma e vlerësimit:

1. Punim i shkruar (analiza e gjendjes në sistemin arsimor/nën-sektor të caktuar dhe perspektiva e ndryshimit) = 20 pikë
2. Testi 1 = 20 pikë
3. Provimi final – 60%.

Detajet e vlerësimit për secilën detyrë do të ofrohen në mënyrë të detajuar nga mësuesi i kursit në afat të caktuar.

Skema e vlerësimit

Pikët	Nota
91-100 %	10
81- 90 %	9
71- 80 %	8
61- 70 %	7
55-60 %	6

Referenca dhe stili i shkrimit

Studentët inkurajohen të përdorin stilin akademik gjatë hartimit të detyrave të kursit dhe në rast të shfrytëzimit të burimeve të tjera duhet t'i binden rregullave të APA-s.

Literatura

Literatura e obliguar

Librat:

[1] Fullan, M. (2003). Forcat e ndryshimit: depërtim në thellësi të reformës arsimore. Tiranë: SOROS (versioni i përkthyer në shqip).

[2] Fullan, M. (2001). Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim. Tiranë: Edualaba (versioni i përkthyer në shqip).

[3] Charles Lusthaus, Marie Helen Adrien, Gary Anderson & Fred Carden (1999) Përmirësimi i performancës së organizatës. Ontario: IDRC (botuar në shqip në 2005).

Artikujt shkencor:

1. Theodore Stefan Kaniuka. (2012). Toward an understanding of how teachers change during school reform: Considerations for educational leadership and school improvement. *Journal of Educational Change*, 13:327–346

2. Klaas Van Veen; Peter Slegers. (2009). How does it feel? Teachers' emotions in a context of change. *Journal of Curriculum Studies*, 38: 1, 85 — 111.

3. Kenneth Leithwood. (2001). School leadership in the context of accountability policies. *International Journal of Leadership in Education*. 4:3, 217 - 235.

4. Michael Fullan (2006). The future of educational change: system thinkers in action. *Journal of Educational Change*,7:113–122

5. Judyth Sachs (2003) Teacher Professional Standards: Controlling or developing teaching? *Teachers and Teaching: Theory and Practice*, 9:2, 175-186.

Literatura plotësuese

[3] Elmore, R. (2011). Reforma shkollore nga brenda jasht: Politika, praktika dhe performanca. Tiranë: Ufopress (versioni në shqip).

[4] Owens, R. (2004). Organizational behavior in education: Adaptive leadership and school reform. Boston: Pearson Education.

[5] Hargreaves, A., & Shirley, D. (2009). The fourth way: The inspiring future for educational change. London: Corwin Press.